L I G J
Nr.8914, datë 20.6.2002

PËR RATIFIKIMIN E AMENDAMENTIT TË MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN "REHABILITIMI URGJENT I FURNIZIMIT ME UJË"

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Amendamenti i marrëveshjes së kredisë të zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin "Rehabilitimi urgjent i furnizimit me ujë"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3394, datë 3.7.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani

AMENDAMENT NR. 1
NË MARRËVESHJEN E KREDISË SË ZHVILLIMIT PËR PROJEKTIN "REHABILITIMI URGJENT I FURNIZIMIT ME UJË" NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA)

Shkronja "b" e pikës 2/1 të listës nr.1, ndryshohet si vijon:
"pagesat në shumën ekuivalente me 2 000 000 SDR të bëra për shpenzimet në kategorinë (1) (a) për punimet e rehabilitimit, në qoftë se kontrata për operatorin privat do të miratohet deri më 30 qershor të vitit 2002".

PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISËNDËRKOMBËTARE

PËR SHOQATËN PËR ZHVILLIM (IDA)